

20221732420

## L I G J I STABILITETIT FINANCIAR(\*)

### I. Dispozitat themelore

#### Neni 1

Me këtë ligj rregullohen qëllimet, statusi, detyrat dhe mënyra e punës së Komitetit të Stabilitetit Financiar, si dhe instrumentet dhe mënyra e zbatimit të politikës makroprudenciale të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

#### Neni 2

### Definicionet

Shprehje të veçanta të këtij ligji kanë kuptimin si më poshtë:

1) "**Strategjia për zbatimin e politikës makroprudenciale**" (në tekstin në vijim: Strategjia Makroprudenciale) është strategji që përfshin treguesit për identifikimin dhe monitorimin e rreziqeve sistematike, të instrumenteve dhe të aktiviteteve për të parandaluar, zvogëluar ose eliminuar rreziqe sistematike në një ose më shumë segmente të sistemit financiar, me qëllim të ruajtjes së stabilitetit dhe sistemit financiar në tërësi;

2) "**Politika makroprudenciale**" është përmbledhje e aktiviteteve që kontribuojnë në arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit financiar;

3) "**Instrumente makroprudenciale**" janë instrumente që mund të përdoren për të parandaluar, zvogëluar ose eliminuar rreziqe sistematike në segmente të caktuara të sistemit financiar;

4) "**Masa makroprudenciale**" janë masat që ndërmerren në lidhje me lartësinë e instrumenteve makroprudenciale dhe masa të tjera me qëllim parandalimin, zvogëlimin ose eliminimin e rreziqeve sistematike në segmente të veçanta të sistemit financiar ose në sistemin financiar në tërësi;

5) "**Organet kompetente**" janë Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin në vijim: Banka Popullore), Ministria e Financave (në tekstin në vijim: Ministria), Komisioni i Letrave me Vlerë i Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejshëm: KLV), Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve (në tekstin në vijim: AMS) dhe Agjencia e Mbikëqyrjes së Financimit Kapital të Sigurimit Pensional (në tekstin në vijim: MAPAS);

6) "**Rekomandimi**" është një dokument i shkruar që identifikon nevojën për të vendosur, ndërmarrë, ndryshuar ose hequr masa makroprudenciale dhe / ose instrumente që janë në kompetencë të organit kompetent të caktuar, në mënyrë që të parandalojë ose zvogëlojë rrezikun sistematik të identifikuar. Rekomandimi gjithashtu mund të jepet në lidhje me nevojën për ndryshime në rregullore;

7) "**Segmente të sistemit financiar**" është sistemi bankar, sistemi i sigurimeve, fondet pensionale, fondet e investimeve, shoqëritë për menaxhim e fondeve pensionale, shoqëritë për menaxhim me fondet e investimeve, shtëpitë e brokerimit, shoqëritë financiare, ofrues të lizingut financiar dhe tregjet financiare dhe institucionet financiare që përbëjnë infrastrukturën e tregut;

---

\* Me këtë ligj bëhet harmonizimi i Regullativës (BE) me numër 1092/2010 të Parlamentit dhe të Këshillit Europian të datës 24 nëntor të vitit 2010 për mbikëqyrje makroprudenciale të sistemit financiar të Bashkimit Europian dhe formimi i Këshillit Europian për Rrezik Sistemor (CELEX nr. 32010R1092).

8) "**Ligjet sektoriale**" janë ligjet që rregullojnë punën e Bankës Popullore, të sistemit bankar, të sistemit të sigurimeve, të sistemit pensional, të tregjeve financiare dhe instrumenteve, фондеве të investimeve, të shoqërive për menaxhim të фондеве të investimeve, të shoqërive financiare dhe ofruesve të lizingut financiar dhe ligjeve të tjera që rregullojnë punën dhe kompetencat e organeve kompetente dhe të Fondit të Sigurimit të Depozitave;

9) "**Rreziku i sistemit**" është rreziku nga prishja në sistemin financiar, i cili mund të shkaktojë pasoja serioze negative për sistemin financiar dhe ekonominë në tërësi;

10) "**Institucion financiar i rëndësisë sistemore**" është institucion financiar i cili nëse punon me probleme serioze ose e ndërpret punës (dështon), mund të çojë në shfaqjen e rrezikut të sistemit, dhe i cili është i identifikuar si sistematikisht i rëndësishëm në përputhje me ligjin që rregullon punën e institucioneve financiare të veçanta;

11) "**Sisteme pagese të rëndësisë sistemore**" janë sistemet e pagesave që plotësojnë kriteret për sistemet e rëndësishme të pagesave sistematike në përputhje me kriteret për klasifikimin e sistemeve të pagesave sipas rëndësisë së tyre në sistemin e pagesave të vendit të përcaktuara në Vendimin për kriteret dhe standardet për punën e sistemet e pagesave;

12) "**Sugjerime**" është dokument i shkruar që vlerëson nevojën për aktivitete ose lëvizje të caktuara në sistemin financiar, në segmente të caktuara të sistemit financiar ose në një ose më shumë institucione financiare për t'u ndjekur më nga afër, sepse ato mund të jenë burim i mundshëm i rrezikut të sistemit;

13) "**Institucion financiar**" është person juridik në Republikën e Maqedonisë së Veriut, i cili është bankë, kursimore, shoqëri për menaxhimi të фондеве të investimeve, shtëpi brokerimi, shoqëri sigurimesh, shoqëri për ri-sigurime, shoqëri për menaxhim me fondet pensionale, ofrues i lizingut financiar, shoqëri financiare dhe çdo person tjetër që është lëndë e mbikëqyrjes së organeve kompetente në përputhje me ligjin;

14) "**Kriza financiare**" është gjendje në të cilën prishjet në një ose më shumë segmente të sistemit financiar ose gjendje të tjera në ekonomi rrezikojnë seriozisht ose mund të rrezikojnë qëndrueshmërinë e sistemit financiar dhe funksionimin normal të tij;

15) "**Sistem financiar**" është sistem që e përbëjnë të gjitha institucionet financiare, tregjet financiare, produktet dhe shërbimet financiare dhe infrastruktura e tregut financiar dhe

16) "**Stabilitet financiar**" është gjendje në të cilën të gjitha segmentet e sistemit financiar funksionojnë pa ndërprerje dhe kanë aftësinë për t'u bërë ballë goditjeve të potenciale.

Neni 3

### **Pavarësia**

Dispozitat e këtij ligji nuk ndikojnë në pavarësinë e organeve kompetente dhe e rregullojnë punën e tyre, nëse sipas ligjeve të sektorëve nuk është e rregulluar ndryshe.

## **II. Komiteti i Stabilitetit Financiar**

Neni 4

### **Qëllimi i statusit të Komitetit**

(1) Komiteti i Stabilitetit Financiar (në tekstin në vijim: Komiteti) formohet si trup ndërinstitutional përgjegjës për ndjekjen e zbatimin e politikës makroprudenciale në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe për bashkërendimin e aktiviteteve gjatë identifikimin dhe ndjekjes së rreziqeve sistemore në segmente të veçanta nga sistemi financiar, që mund të ndikojnë në segmente të caktuara edhe në sistemin financiar në tërësi, gjatë ndërmarrjes së masave makroprudenciale dhe gjatë përgatitjes dhe menaxhimit me kriza financiare.

(2) Qëllimi i Komitetit është të kontribuojë për arritjen dhe mbajtjen e stabilitetit financiar në vend.

## Neni 5

### **Detyrat e Komitetit**

Për realizimin e qëllimit të tij, Komiteti i kryen këto detyra:

- 1) miraton strategjinë makroprudenciale të nenit 15 të këtij ligji, si dhe ndryshimet dhe/ose plotësimet e tij dhe kujdeset për zbatimin e tyre;
- 2) ndjek dhe vlerëson gjendjet në sistemin financiar;
- 3) jep sugjerime dhe rekomandime për shkak parandalimit ose zvogëlimit të rreziqeve në sistem dhe mbajtjen e stabilitetit financiar dhe ndjek zbatimin e tyre;
- 4) shqyrton masat makroprudenciale që kanë ndërmarrë organet e veçanta kompetente dhe vlerëson efektet e këtyre masave;
- 5) jep udhëzime për punën e Nënkomiteteve të nenit 10 të këtij ligji dhe shqyrton analizat, informacionet, propozimet dhe procesverbalet e marra nga Nënkomitetet;
- 6) vlerëson nevojën për përmirësimin e rregullave ligjore dhe të akteve nënligjore përkatëse;
- 7) vlerëson gatishmërinë e organeve kompetente dhe Fondit të Sigurimit të Depozitave për ballafaqimin e krizës financiare;
- 8) bashkërendon bashkëpunimin ndërmjet organeve kompetente në kushte kur nuk ekziston krizë financiare;
- 9) vendim për ekzistimin dhe ndërprerjen e krizës financiare;
- 10) bashkërendon bashkëpunimin ndërmjet organeve kompetente dhe Fondit të Sigurimit të Depozitave në kushte të krizës financiare të mundshme ose të krijuar për shkak udhëheqjes së duhur të krizës financiare;
- 11) bashkëpunon me organe ose trupa përkatës jashtë vendit, kompetente për udhëheqjen e politikës makroprudenciale dhe me organizata ndërkombëtare financiare dhe
- 12) kryen aktivitete të ndryshme për realizimin e qëllimit dhe kryerjen e detyrave të këtij ligji.

## Neni 6

### **Përbërja e Komitetit**

- (1) Komiteti përbëhet prej 13 anëtarëve.
- (2) Anëtarë të Komitetit janë guvernatori i Bankës Popullore, ministri i Financave, kryetari i KLV-së, kryetari i Këshillit të Ekspertëve të AMS-së, kryetari i Këshillit të Ekspertëve të MAPAS-it, pesë përfaqësues të Bankës Popullore të përcaktuar nga guvernatori i Bankës Popullore dhe tre përfaqësues nga Ministria të përcaktuar nga ministri i Financave.
- (3) Anëtarë të Komitetit me të drejtë vote janë guvernatori i Bankës Popullore, ministri i Financave, kryetari i KLV-së, kryetari i Këshillit të Ekspertëve të AMS-së dhe kryetari i Këshillit të Ekspertëve të MAPAS-it.
- (4) Anëtarët e Komitetit pa të drejtë vote duhet të kenë njohuri, aftësi profesionale dhe përvojë pune prej së paku pesë vjetësh në fushën e financave.

## Neni 7

### **Mënyra e punës së Komitetit**

- (1) Komiteti punon në seanca, që nuk janë publike.

(2) Me seancat e Komitetit udhëheq guvernatori i Bankës Popullore dhe në kushte të krizës financiare, mund të udhëheq edhe ministri i Financave, derisa ashtu vendosin guvernatori i Bankës Popullore dhe ministri i Financave.

(3) Guvernatorin e Bankës Popullore, përkatësisht ministrin e Financave, në rastet sipas paragrafit (2) të këtij neni, e përfaqëson Komiteti para Publikut.

(4) Komiteti mbanë mbledhje së paku dy herë në vit.

(5) Seancat e Komitetit thirren nga guvernatori i Bankës Popullore përkatësisht ministri i Financave në rastet nga paragrafi (2) i këtij neni me iniciativë të tij ose me kërkesë të së paku një anëtarit të Komitetit, me të drejtë vote.

(6) Seancat e Komitetit mbahen nëse janë të pranishëm shumicë e anëtarëve me të drejtë vote, mes të cilëve patjetër guvernatori i Bankës Popullore dhe ministri i Financave.

(7) Në seancat e Komitetit që mbahen në rastet sipas neneve 20 dhe 21 të këtij ligji, detyrimisht marrin pjesë guvernatori i Bankës Popullore, ministri i Financave dhe anëtari i organit kompetent për mbikëqyrje të segmentit të sistemit financiar në të cilën identifikohen probleme serioze.

(8) Komiteti vendos me shumicë të votave nga anëtarët me të drejtë vote dhe miraton konkluzione dhe jep sugjerime dhe rekomandime me shkrim.

(9) Me përjashtim të paragrafit (8) të këtij neni, në seancat e Komitetit që mbahen në rastet sipas neneve 20 dhe 21 të këtij ligji, vendoset me konsensus të guvernatorit të Bankës Popullore dhe ministrit të Financave

(10) Materialet, informacionet, konkluzionet, rekomandimet, sugjerimet dhe procesverbalet nga mbledhjet e Komitetit janë konfidenciale.

(11) Komiteti miraton Rregullore të punës, me të cilën në mënyrë më të hollësishme rregullohet mënyra e punës së tij.

(12) Nëse ka nevojë, në seancat e Komitetit mund të thirret drejtori i Fondit të Sigurimit të Depozitave ose persona tjerë që janë profesionist të fushës që është lëndë e diskutimit në seanca.

## Neni 8

### **Komunikimi me publikun**

(1) Komiteti njofton publikun për seancat e mbajtura përveç nëse vlerëson se njoftimi mund të ndikojë në mënyrë negative besimin e publikut në sistemin financiar ose mbi stabilitetin financiar.

(2) Guvernatori i Bankës Popullore, përkatësisht ministri i Financave në rastet sipas nenit 7, paragrafi (2) të këtij ligji është përgjegjës për menaxhimin e procesit të komunikimit me publikun dhe për bashkërendimin e ndërsjellë të organeve kompetente dhe të Fondit të Sigurimit të Depozitave në lidhje me komunikimin me publikun.

(3) Në kushte të krizës financiare, guvernatori i Bankës Popullore dhe ministri i Financave japin deklarata të përbashkëta në publik.

## Neni 9

### **Raportet**

Komiteti më së voni deri më 31 mars të viti aktual njofton Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut për punën e tij, duke dorëzuar raportin e punës për vitin pararendës.

### **III. Nënkomitetet dhe Sekretariati**

#### Neni 10

#### **Nënkomitetet**

(1) Për shkak të kryerjes së detyrave të Komitetit, të përcaktuara sipas nenit 5 të këtij ligji, formohen dy nënkomitete si trupa ndihmës të Komitetit

1) Nënkomitet për ndjekje të rreziqeve të sistemit dhe propozim të masave makroprudenciale dhe

2) Nënkomitet për përgatitjen e menaxhimit të krizës financiare.

3) Anëtarët e Nënkomiteteve duhet të kenë dituri, aftësi profesionale dhe përvojë pune prej së paku pesë vjetësh në fushën e financave.

#### Neni 11

#### **Mënyra e punës së Nënkomiteteve**

(1) Nënkomitetet punojnë në seanca, që nuk janë publike.

(2) Seancat e Nënkomitetit i udhëheq kryesuesi i përcaktuar nga guvernatori i Bankës Popullore, në përputhje me nenin 12, paragrafi (2) dhe nenin 13, paragrafi (2) të këtij ligji.

(3) Seancat e Nënkomitetit thirren nga udhëheqësin e Nënkomitetit me iniciativë të vet, me kërkesë të Komitetit ose me kërkesë të më së paku një anëtari të Nënkomitetit.

(4) Seancat e Nënkomiteteve mbahen nëse janë prezent shumicë e anëtarëve, midis të cilave detyrimisht udhëheqësi.

(5) Nënkomitetet mblidhen së paku një herë në tre muaj.

(6) Nëse ka nevojë, në seancat e Nënkomiteteve mund të ftohen edhe persona të tjerë që janë profesionist në fushën që është lëndë e diskutimit në seancat.

(7) Nga seancat e mbajtura, Nënkomitetet përgatitin procesverbale që i dorëzojnë në Komitet. Nëse njëri nga anëtarët e Nënkomitetit ka mendim ndryshe, shënohet në procesverbalin e Nënkomitetit.

(8) Materialet, informacionet dhe procesverbalet nga mbledhjet të Nënkomiteteve janë konfidenciale.

(9) Nënkomitetet miratojnë Rregulloren e punës, që në mënyrë të hollësishme rregullohet mënyra e punës së tyre.

#### Neni 12

#### **Nënkomiteti për ndjekje të rreziqeve të sistemit dhe propozim të masave makroprudenciale**

(1) Nënkomiteti për monitorim të rreziqeve të sistemit dhe propozim të masave makroprudenciale ka 12 anëtarë.

(2) Anëtarë të Nënkomitetit për monitorim të rreziqeve të sistemit dhe propozim të masave makroprudenciale janë katër nga Banka Popullore, të përcaktuar nga guvernatori i Bankës Popullore, prej të cilëve njëri është drejtues; dy përfaqësues nga Ministria të përcaktuar nga ministri i Financave; dy përfaqësues nga AMS-ja, të përcaktuar nga kryetari i Këshillit të AMS-së; dy përfaqësues nga KLV-ja, të përcaktuar nga kryetari i KLV-së dhe dy përfaqësues nga MAPAS-I, të përcaktuar nga kryetari i Këshillit të Ekspertëve të MAPAS-it.

(3) Nënkomiteti për monitorim të rreziqeve të sistemit dhe propozim të masave makroprudenciale i kryen këto detyra:

1) ndjek rreziqet që mund të shkaktojnë rreziqe të sistemit, nëpërmjet shqyrtimit të treguesve për rreziqe të sistemit të përcaktuar nga organet kompetente dhe të të dhënave dhe informacioneve sipas nenit 16, paragrafi (1) pika 3) dhe nenit 22 të këtij ligji dhe analizat për rreziqet në segmente të veçanta nga sistemi financiar të përgatitura nga organet kompetente;

2) shqyrton rezultatet e testimit të stresit të rezistencës së segmenteve nga sistemi financiar të goditjeve të supozuara nëse ato bëhen nga organet kompetente;

3) analizon masat makroprudenciale që kanë ndërmarrë organet kompetente ose planifikojnë t'i ndërmarrin dhe ndjek zbatimin e masave dhe efektet e atyre masave;

4) shqyrton raportet për sistemet e rëndësishme të pagesave të sistemit të përgatitura nga Banka Popullore;

5) jep propozime për rekomandime ose sugjerime në Komitet;

6) shqyrton aktet ligjore dhe nënligjore që mund të kenë ndikim në stabilitetin financiar ose propozimet për ndryshimin dhe/ose plotësimin e tyre dhe jep mendim për nevojën e ndryshimit dhe plotësimit të tyre;

7) ndjek masat makroprudenciale të ndërmarra nga vendet tjera, veçanërisht nëse ato masa mund të kenë ndikim në vend;

8) jep propozime në Komitet për ndryshimin dhe/ose plotësimin e treguesve për rreziqet e sistemit të përcaktuara nga organet kompetente dhe instrumentet makroprudenciale të përfshira në strategjinë makroprudenciale;

9) jep propozime në Komitet për ndryshimin dhe/ose plotësimin e strategjisë makroprudenciale dhe

10) kryen detyra të tjera të marra nga Komiteti lidhur me realizimin e qëllimit dhe kryerjen e detyrave të këtij ligji.

### Neni 13

#### **Nënkomiteti për përgatitjen e menaxhimit të krizës financiare**

(1) Nënkomiteti për përgatitjen e menaxhimit të krizës financiare ka dhjetë anëtarë.

(2) Anëtarë të Nënkomitetit për përgatitjen e menaxhimit të krizës financiare janë tre përfaqësues nga Banka Popullore, të përcaktuar nga guvernatori i Bankës popullore nga të cilët njëri është kryetar; tre pjesëmarrësit nga Ministria të përcaktuar nga ministri i Financave; një përfaqësues i AMS-së, i përcaktuar nga kryetari i Këshillit të Ekspertë të AMS-së, një përfaqësues nga KLV-ja, i përcaktuar nga kryetari i KLV-së; një përfaqësues i MAPAS-it, i përcaktuar nga kryetari i Këshillit të Ekspertëve të MAPAS-it dhe një përfaqësues nga Fondi i Sigurimit të Depozitave, i përcaktuar nga drejtori i Fondit të Sigurimit të Depozitave.

(3) Nënkomiteti për përgatitjen e menaxhimit të krizës financiare i kryen këto detyra:

1) shqyrton ligjet dhe aktet nënligjore që janë të zbatueshme në kushte të krizës financiare dhe jep mendime për nevojën e ndryshimit dhe/ose plotësimin e tyre;

2) përgatit ushtrime për menaxhimin e krizës financiare dhe bashkërendon aktivitetet e institucioneve të përfshira në ushtrim;

3) shqyrton procedurat e organeve kompetente të veçanta dhe të Fondit të Sigurimit të Depozitave për veprim në rast të krizës financiare;

4) përgatit procedura për bashkërendimin e aktiviteteve të organeve kompetente të veçanta dhe të Fondit të Sigurimit të Depozitave në rast të krizës financiare dhe

5) kryen detyra tjera të marra nga Komiteti lidhur me realizimin e qëllimit dhe kryerjen e detyrave të këtij ligji.

## Neni 14

### **Sekretariati**

(1) Sekretariati siguron mbështetjen e plotë administrative dhe logjistike të Komitetit dhe të Nënkomiteteve gjatë realizimit të detyrave sipas këtij ligji dhe gjatë organizimit të seancave.

(2) Sekretariatit e përbëjnë tre persona të punësuar në Bankën Popullore, të përcaktuar nga guvernatori i Bankës Popullore.

(3) Organet kompetente janë të detyruar t'i dorëzojnë në Sekretariat informacionet dhe të dhënat e kërkuara në lidhje me pikat e rendit të ditës të Komitetit dhe të Nënkomiteteve.

(4) Anëtarët e Sekretariatit duhen të kenë njohuri, aftësi profesionale dhe përvojë pune prej së paku tre vjetësh në fushën e financave.

## **IV. Politika makroprudenciale dhe zbatimi i saj**

## Neni 15

### **Politika makroprudenciale dhe strategjia makroprudenciale**

(1) Qëllimi kryesor i politikës makroprudenciale është të kontribuojë për arritjen dhe rruajtjen e stabilitetit të sistemit financiar në tërësi përmes parandalimit dhe zvogëlimit të akumulimit të rreziqeve të sistemit, përforcimin e rezistencës së sistemit dhe sigurimin e kontributit të qëndrueshëm të sistemit financiar të rritjes ekonomike.

(2) Qëllimi kryesor i paragrafit (1) të këtij neni realizohet nëpërmjet qëllimeve të tërthorta të politikës makroprudenciale, që janë pjesë përbërëse e strategjisë makroprudenciale.

(3) Qëllimet e tërthorta të politikës makroprudenciale, përcaktohen, ndryshohen dhe/ose plotësohen në varësi të lëvizjeve të sistemit financiar, të ndryshimeve të strukturës së tij, të modelit afarist të institucioneve financiare, të nivelit të zhvillimit të sistemit financiar, të paraqitjeve të reja ose zvogëlimi i rëndësisë së rreziqeve të caktuara, si dhe ndryshimet në standardet përkatëse ndërkombëtare.

(4) Në strategjinë makroprudenciale përcaktohen qëllimet e tërthorta të paragrafit (2) të këtij neni dhe kanë të bëjnë me instrumentet makroprudenciale dhe tregues për ndjekjen e rreziqeve në segmente të caktuara të sistemit financiar, për shkak identifikimit në kohë të rreziqeve të sistemit.

(5) Realizimi i qëllimit kryesor të politikës makroprudenciale mundësohet nëpërmjet ndjekjes në kohë dhe efikase të treguesve për ndjekje të rreziqeve dhe të instrumenteve nga strategjia makroprudenciale dhe përcaktimi i nevojës për futje, ndryshim ose heqje të masave dhe instrumenteve makroprudenciale.

## Neni 16

### **Aktivitetet e organeve kompetente**

(1) Secili organ kompetent është i detyruar të:

- 1) marrë pjesë në punën e Komitetit dhe Nënkomiteteve, në përputhje me këtë ligj;
- 2) kontribuojë gjatë përgatitjes së strategjisë makroprudenciale dhe gjatë zbatimit të tij segmenteve të sistemit financiar në kompetencë të tij;
- 3) ndjek treguesit për rrezikun e sistemit për segmentin e sistemit financiar në kompetencë të tij;

4) identifikojë rreziqet që mund të zgjerohen nga segmenti i sistemit financiar në kompetencë të tij dhe/ose të çojë në shfaqjen e rrezikut të sistemit dhe të njoftojë Nënkomitetin për ndjekje të rreziqeve të sistemit dhe propozim të masave makroprudenciale;

5) nëse është e zbatueshme, përcakton mënyrën e përcaktimit të institucioneve të sistemit të rëndësishëm financiar në kompetencë të tij në përputhje me ligjin;

6) përcaktojë instrumentet makroprudenciale dhe ndërmerr masa makroprudenciale të segmentit të sistemit financiar në kompetencë të tij, në përputhje me këtë ligj dhe ligjet sektoriale;

7) jep propozime Nënkomitetit për ndjekjen e rreziqeve të sistemit dhe propozimin e masave makroprudenciale për ndryshimin dhe/ose zbatimin e strategjisë makroprudenciale;

8) zbatojë rekomandimet e dhëna nga Komiteti ose jep arsyetim me shkrim për arsyet për të cilat llogarit se nuk është e mundur ose nuk është e arsyetueshme të veprojë në përputhje me rekomandimet;

9) shqyrtojë dhe vendos për zbatimin e sugjerimeve të dhëna nga Komiteti;

10) përgatit akte për veprim në rast të krizës financiare;

11) përgatitet për menaxhimin e krizës financiare;

12) bashkëpunojë dhe shkëmbejë të dhëna dhe informacione me organe të tjerë kompetente, jashtë seancave të Komitetit dhe të Nënkomitetit, në bazë të marrëveshjes / memorandumit për bashkëpunim;

13) merr pjesë në menaxhimin bashkërendues të krizës financiare dhe

14) aktivitete të tjera në përputhje me këtë ligj, e në lidhje me arritjen e qëllimit dhe realizimin e detyrave të këtij ligji.

(2) Gjatë realizimit të aktiviteteve të paragrafit (1) të këtij neni, organet kompetente veprojnë në suaza të kompetencave të tyre të përcaktuara me këtë ligj dhe me ligjet sektoriale.

(3) Organet kompetente kontribuojnë në zbatimin e strategjisë makroprudenciale me mbledhjen dhe monitorimin e të dhënave dhe informacioneve për institucionet financiare të segmentit të sistemit financiar në kompetencë të tyre, duke ndërmarrë masa për mbikëqyrje në përputhje me këtë ligjet sektoriale dhe duke ndërmarrë masa makroprudenciale në përputhje me këtë ligj dhe/ose ligjet sektoriale.

(4) Përveç aktiviteteve të paragrafit (1) të këtij neni, për të arritur qëllimin për të kontribuar ndaj arritjes dhe rruajtjes së stabilitetit financiar në Republikën e Maqedonisë së Veriut në përputhje me ligjin, Banka Popullore kryen edhe këto aktivitete:

1) përgatit strategjinë makroprudenciale të nenit 15 të këtij ligji dhe ndryshimet dhe/ose plotësimet e tij dhe e propozon në Komitet;

2) identifikon rreziqet që mund të prishin stabilitetin financiar, që përfshinë ndjekje të rreziqeve të sistemit në sistemin bankar dhe në segmentet e tjera të sistemit të financave, ndjekje e lidhshmërisë ndërmjet segmenteve të veçanta të sistemit financiar dhe i dorëzon informacione Nënkomitetit për ndjekje të rreziqeve të sistemit dhe propozimin e masave makroprudenciale;

3) përgatit raport vjetor për stabilitetin financiar në përputhje me nenin 62 të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe

4) bashkëpunojë dhe kërkojë të dhëna dhe informacione nga institucionet financiare, organet kompetente, organet e drejtorisë financiare, ndërmarrjet publike, institucionet publike dhe shoqëritë tregtare të themeluara nga shteti ose në të cilat shteti është pronar dominues dhe institucione të tjera, shoqëri, fonde, agjenci, shoqata.

5) Subjektet e paragrafit (4), pika 4) të këtij neni janë të detyruar të veprojnë ndaj kërkesës së Bankës Popullore dhe të dorëzojnë të dhëna dhe informacione të plota dhe të sakta në Bankën Popullore në afatin e shënuar në kërkesë. Nëse ndonjë nga subjektet nuk arrin të sigurojë të dhëna dhe informacione në afatin e shënuar në kërkesë, Banka Popullore mund të përcaktojë afat të ri për dorëzimin e të dhënave.

(6) Të dhënat nga paragrafi (4), pika 4) të këtij neni dorëzohen pa kompensim.



## Neni 17

### **Ndërmarrja e masave makroprudenciale**

(1) Organet kompetente, në suaza të kompetencave të tyre lidhur me instrumentet makroprudenciale që mund ti referohen:

- 1) shtresave mbrojtëse të kapitalit;
- 2) limitit të ekspozimit;
- 3) menaxhimit me rreziqet;
- 4) obligueshmërisë;
- 5) institucioneve të rëndësishme financiare të sistemit
- 6) rrezikut nga koncentrimi i ekspozimit dhe

7) instrumenteve të tjera për rritjen e rezistencës ndaj goditjeve financiare dhe për parandalimin e shqetësimeve në segmentet e sistemit financiar.

(2) Masat e përmbajtura në ligjet sektoriale që mund të ndërmerren ndaj një ose më shumë institucioneve, mund të përdoren edhe për realizimin e qëllimeve të politikës makroprudenciale, në përputhje me këtë ligj.

(3) Për shkak të zbatimit të instrumenteve makroprudenciale dhe/ose veprimit sipas rekomandimit të Komitetit, organet kompetente mund t'i përcaktojnë nga afër metodologjinë, llojin, përmbajtjen, kohëzgjatjen dhe mënyrën e zbatimit të instrumenteve makroprudenciale dhe masat në segmentet nga sistemi financiar në kompetencë të tyre në përputhje me ligjin.

(4) Organi kompetent me qëllim që të ndërmarrë, ndryshoj ose heqë masë të caktuar makroprudenciale mund ta informojë Nënkomitetin për ndjekjen e rreziqeve sistemore dhe propozimin e masave makroprudenciale, për çka Nënkomiteti dorëzon informacion me mendim deri te Komiteti.

(5) Organi kompetent është i obliguar, në afat prej pesë ditëve pas ndërmarrjes, ndryshimit ose heqjes së masës makroprudenciale, ta informojë Nënkomitetin për ndjekjen e rreziqeve sistemore dhe propozimin e masave makroprudenciale, për çka Nënkomiteti dorëzon informacion me mendim deri te Komiteti.

## Neni 18

### **Sugjerime dhe rekomandime**

(1) Që t'i parandaloj, zvogëloj ose ti largoj rreziqet sistemore, Komiteti jep sugjerime dhe rekomandime deri te organet kompetente, së bashku me arsyetim të shkaqeve për të cilat jepet sugjerimi, gjegjësisht me arsyetim të shkaqeve për të cilat jepet rekomandimi me afatet për plotësimin e rekomandimeve.

(2) Komiteti mund të japë sugjerim edhe deri te institucionet shtetërore dhe organet në Republikën e Maqedonisë së Veriut, nëse aktivitetet e atyre institucioneve shtetërore dhe/ose ngjarjet në segmentet që janë nën kompetencë të tyre, mund të paraqesin burim potencial të rrezikut sistematik dhe të ndikojnë mbi stabilitetin financiar.

(3) Gjatë dhënies së rekomandimit, Komiteti mund të shënoj dhe masa konkrete dhe instrumente për zbatimin e tyre.

(4) Komiteti e ndjek veprimin e rekomandimit të dhënë. Gjatë dhënies së rekomandimit Komiteti mund të shënoj edhe afate në të cilat organi kompetent duhet ta njoftoj për veprimin dhe për efektet nga zbatimi i rekomandimit.

(5) Komiteti jep sugjerime dhe rekomandime sipas vlerësimit të tij ose me propozim të Nënkomitetit për ndjekjen e rreziqeve sistemore dhe propozimin e masave makroprudenciale.

(6) Komiteti mund të vendos ta njoftoj publikun për rekomandimin e dhënë, në përputhje me nenin 7 paragrafi (8) të këtij ligji, vetëm nëse vlerëson se njoftimi mund të ndikoj negativisht në besimin e publikut në sistemin financiar ose mbi stabilitetin financiar.

Neni 19

**Veprim i organeve kompetente**

(1) Organi komentet është i obliguar që në afat prej 15 ditëve të punës nga marrja e rekomandimit ta njoftoj Komitetin për mënyrën në të cilën do ta zbatoj rekomandimin ose të jap arsyetim me shkrim për shkaqet për të cilat llogaritet se nuk është e mundur ose nuk është e arsyeshme të veprojnë në përputhje me rekomandimin.

(2) Nëse rekomandimi nuk përmbushet në afat të cilin e ka caktuar Komiteti ose nëse Komiteti vendos se arsyetimi nga paragrafi (1) i këtij neni nuk e arsyeton moszbatimin e rekomandimit, Komitetit i përcakton periudhë plotësuese organit kompetent që ta zbatoj rekomandimit ose afat praj shtatë ditë pune që të jep arsyetim shtesë për moszbatimin.

**V. Kriza financiare**

Neni 20

**Përcaktimi i krizës financiare**

(1) Nëse Banka Popullore ose Ministria vlerëson se ekzistojnë probleme serioze të njëra ose më shumë banka ose institucione financiare në segment tjetër nga sistemi financiar ose gjendje të tjera në ekonominë të cilat e prishin ose mund të çojnë në prishje serioze të stabilitetit financiar, guvernatori i Bankës Popullore dhe ministri i Financave menjëherë njoftohen me shkrim ndërmjet vete.

(2) Nëse Nënkomiteti për ndjekjen e rreziqeve sistimore dhe propozimin e masave makroprodnenciale identifikon probleme serioze të njëri prej segmenteve të sistemit kryesor ose nëse organet kompetente identifikojnë probleme serioze të një ose më shumë institucione publike nën kompetencë të tyre që e prishin ose mund të çojnë në prishje serioze të stabilitetit financiar, menjëherë i njoftojnë guvernatorin e Bankës Popullore dhe Ministrin e Financave.

(3) Në rastet nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, guvernatori i Bankës Popullore menjëherë thirr seancë të Komitetit në përputhje me nenin 7, paragrafi (7) të këtij ligji.

(4) Nëse anëtarët e Komitetit në përputhje me nenin 7 paragrafi (9) i këtij ligji përcaktojnë ekzistim të krizës financiare sjellin konkluzion për ekzistimin e krizës financiare.

(5) Ekzistimi i krizës financiare përcaktohet në bazë të vlerësimit mbikëqyrës të organit kompetent për gjendjet në një ose më shumë institucione të cilat janë identifikuar probleme serioze dhe në bazë të vlerësimit të Ministrisë për gjendjen makroekonomike në vend, së bashku me Bankën Kombëtare për përhapjen e mundshme të rreziqeve mbi segmentet e tjera të sistemit financiar, sistemit financiar në tërësi dhe / ose ekonomisë.

(6) Ministri i Financave menjëherë e informon Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut për konkluzionin e paragrafit (4) të këtij neni.

Neni 21

**Aktivitetet në kushte të krizës financiare**

(1) Pas miratimit të konkluzionit për ekzistimin e krizës financiare, Komiteti i siguron dhe i shqyrton:

1) informacionet dhe analizat për gjendjet në një ose më shumë institucione financiare të cilat janë identifikuar probleme serioze, të lidhura me aftësinë e pagimit, kualitetin e aktives, likuiditetin, strukturën së burimeve të financimit dhe ose projektimin e rrjedhës së parave;

- 2) vlerësimin e Ministrisë, për gjendjen makroekonomike në vend;
  - 3) vlerësimin e nevojës dhe mundësisë së shfrytëzimit të mjeteve buxhetore për ballafaqimin me krizat;
  - 4) vlerësimin e Fondit të Sigurimit të Depozitave për pagimin e depozitave të siguruara në bankë, nëse institucioni financiar i pikës 1) të këtij paragrafi është bankë;
  - 5) informacionet e dorëzuara nga Nënkomiteti dhe
  - 6) informacionet dhe analizat e tjera.
- (2) Në bazë të vlerësimeve, të informacioneve dhe të analizave të paragrafit (1) të këtij neni, Komiteti vendos për masat dhe aktivitetet që duhen të ndërmerren për menaxhimin e krizës financiare.
- (3) Mjetet buxhetore nga paragrafi (1) pika 3) i këtij neni mund të përdoren në instancë përfundimtare, në kushte kur zgjidhjet financiare që rrjedhin nga sektori privat janë të harxhuara dhe kur të vlerësohet se interesi publik e arsyeton mbështetjen fiskale.
- (4) Nëse vlerësohet ekzistimin i nevojës së shfrytëzimit të mjeteve buxhetore, Ministri i Financave për këtë e njofton Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Mjetet e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për ballafaqimin me krizën financiare sigurohen në bazë të ligjit të veçantë për sigurimin e mjeteve buxhetore për ballafaqimin me krizën financiare.
- (5) Nëse vlerësimet, informacionet dhe analizat sipas paragrafit (1) të këtij neni referojnë në rreziqe sistemore të zvogëluara të cilat më nuk shkaktojnë dështim të sistemit financiar, me çka është siguruar ruajtje e qëndrueshmërisë financiare, Komiteti, në përputhje me nenin 7, paragrafi (9) të këtij ligji, miraton konkluzion për përfundimin e krizës financiare.

## **VI. Shkëmbim i të dhënave dhe i informacioneve, konfidencialitet, konflikt të interesave dhe mbrojtje juridike**

### Neni 22

#### **Shkëmbim i të dhënave dhe i informacioneve me Komitetin**

- (1) Me kërkesë të Komitetit ose Nënkomiteteve, organet kompetente dhe Fondi i Sigurimit të Depozitave janë të detyruara t'i dorëzojnë të gjitha informacionet dhe të dhënat që janë të nevojshme për kryerjen e detyrave sipas këtij ligji.
- (2) Komiteti kërkon nga organet kompetente informacione në formë të shkurtuar ose të përmbledhur me çka të mos mundin të identifikohen institucionet financiare individuale.
- (3) Me përjashtim të paragrafit (2) të këtij neni, nëse Komitetit i nevojiten informacione për institucione financiare individuale, kërkesa deri te organi kompetent i duhur përmban arsyetim për shkaqet për të cilat ato informacione janë rëndësishme për sistemin dhe të nevojshme në rrethanat e dhëna.
- (4) Për nevojat sipas paragrafit (1) të këtij neni, organet kompetente mund të dorëzojnë kërkesë të duhur për dorëzimin e të dhënave dhe informacioneve deri te institucionet financiare në segmentin e sistemit financiar në kompetencë të tyre, të cilat janë të detyruara të veprojnë sipas kërkesës së organit kompetent.
- (5) Për nevojat sipas paragrafit (1) të këtij ligji, organet kompetente mund të bashkëpunojnë dhe të kërkojnë të dhëna dhe informacione dhe nga organet e administratës shtetërore, ndërmarrjet publike, institucionet publike dhe shoqëritë tregtare të themeluara nga shteti ose në të cilat shteti është pronar dominues dhe institucione tjera, shoqëri, fonde, agjenci, shoqata që janë të detyruara të veprojnë sipas kërkesës së organeve kompetente.
- (6) Subjektet sipas paragrafëve (4) dhe (5) të këtij neni janë të detyruar të dorëzojnë të dhëna dhe informacione të plota dhe të sakta deri te organi kompetent në afatin e shënuar në kërkesën. Nëse ndonjëri subjekt nuk arrin ti siguroj të dhënat dhe informacionet në afatin e shënuar në kërkesë, organi kompetent mund të përcaktoj afat të ri për dorëzimin e të dhënave dhe informacioneve.

(7) Me shkëmbimin e të dhënave dhe informacioneve për realizimin e qëllimeve në përputhje me këtë ligj, nuk i shkel dispozitat për konfidencialitet të të dhënave dhe të informacioneve të rregulluara me ligjet e sektoreve.

(8) Të dhënat sipas paragrafëve (1), (2), (3), (4), (5), (6) dhe (7) të këtij neni dorëzohen pa kompensim.

#### Neni 23

### **Konfidencialiteti i të dhënave dhe informacioneve**

(1) Të dhënat dhe informacionet të marra me anë të pjesëmarrjes në punën e Komitetit dhe Nënkomiteteve, si dhe materialet e punës dhe procesverbalet nga puna e Komitetit dhe Nënkomiteteve llogaritet konfidenciale.

(2) Komiteti dhe Nënkomitetet mund t'i shfrytëzojnë informacionet konfidenciale të paragrafit (1) të këtij neni posaçërisht për qëllimin për të cilin janë kërkuar në përputhje me këtë ligj.

(3) Anëtarët e Komitetit dhe Nënkomiteteve dhe të gjithë personat që marrin pjesë në punën e tyre ose kanë marrë pjesë në seancat e Komitetit ose Nënkomiteteve nuk mund t'ua kumtojnë të dhënat dhe informacionet e paragrafit (1) të këtij neni personave të tretë.

(4) Me përjashtim të paragrafëve (1) dhe (3) të këtij neni, të dhënat dhe informacionet mund t'i kumtohen:

1) personave të tretë në formë përmbledhëse me çka nuk mund të identifikohen institucionet individuale ose

2) me kërkesë të gjykatës kompetente në përputhje me ligjin.

(5) Në të dhënat personale zbatohen dispozitat e Ligjit të Mbrojtjes së të Dhënave Personale(\*).

(6) Dispozitat sipas paragrafëve (1), (2), (3), (4) dhe (5) të këtij neni nuk u referohen të dhënave dhe informacioneve që publikohen në përputhje me këtë ligj.

#### Neni 24

### **Konflikt të interesave dhe ndalim i keqpërdorimit të informacioneve konfidenciale**

(1) Anëtarët e Komitetit dhe anëtarët e Nënkomiteteve janë të detyruar të kenë kujdes në konflikt potencial të interesave dhe të ndërmarin masa për shmangien e tyre.

(2) Në raport me veprimin në rast të ekzistimit të konfliktit të interesave, paraqitja e konfliktit të interesave, ndalesa për keqpërdorimin e të dhënave konfidenciale nga ana e anëtarëve të Komitetit dhe anëtarëve të Nënkomiteteve, zbatohen në mënyrë përkatëse dispozitat e Ligjit të Parandalimit të Korrupsionit dhe të Konfliktit të Interesave.

#### Neni 25

### **Mbrojtje juridike**

Anëtarët e Komitetit dhe të Nënkomitetit nuk japin llogari për dëmet ndaj personave të tretë që mund të ndodhin për shkak të masave dhe aktiviteteve për ruajtjen e qëndrueshmërisë financiare, të ndërmarra në bazë të këtij ligji, nëse kanë punuar në korniza të detyrave dhe të autorizimeve të tyre dhe nuk kanë kryer veprë penale.

## VII. Dispozita përfundimtare

### Neni 26

(1) Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj do të miratohen në afat prej nëntë muajve nga hyrja në fuqi të këtij ligji.

(2) Organet kompetente do t'i përcaktojnë anëtarët e Komitetit dhe Nënkomiteteve, kurse Fondi i Sigurimit të Depozitave do ta përcaktojë anëtarin e Nënkomitetit për përgatitje për menaxhim të krizës financiare, ndërkaq në afat prej 30 ditëve nga hyrja në fuqi të këtij ligji do ta njofton Sekretariatit për përfaqësuesit e tyre.

(3) Në seancën e parë konstituive të Komitetit vërtetohet përbërja e Komitetit dhe e Nënkomiteteve.

### Neni 27

Ky ligj hyn në fuqi tetë ditë pas botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.